



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2

Tel. 04 268142; Fax 04268141

Nr. 274 Prot

Tiranë më 23. 03. 2015

V E N D I M

Nr. 30 Datë 23/03/2015

"Për një shtesë në vendimin nr. 14, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil."

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me Vendimin nr. 14, datë 11.03.2015, ka vendosur që të fillojë procesin e mbikëqyrjes në institucionin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit në datën 17.03.2015.

Nisur nga konkluzionet e grupit të mbikëqyrjes, si dhe mbështetur në kërkesën e institucionit, Komisioneri vendosi shtyrjen e afatit të mbikëqyrjes në këtë institucion, për një afat prej 10(dhjetë) ditë kalendarike.

Pasi u verifikua nga grupi i mbikëqyrjes gjendja e administrimit të dokumentacionit në njësitë e varësisë së Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Komisioneri vlerëson se procesi i mbikëqyrjes duhet të vijojë me këto njësi, duke duke filluar me Institutin e Zhvillimit të Arsimit (IZHA) dhe Inspektoriatin Shtetëror të Arsimit (ISHA).

Për këtë arsye,

në zbatim të Rregullores "*Mbi procedurat e Mbikëqyrjes/Inspektimit*", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil dhe në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11/1, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*",

VENDOSA:

1. Të vijojë procesi i mbikëqyrjes në njësitë e varësisë së Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe konkretisht në **Inspektoriatin Shtetëror të Arsimit dhe Institutin e Zhvillimit të Arsimit.**

2. Programi i mbikëqyrjes për administrimin e shërbimit civil në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, është i vlefshëm edhe për njësitë e varësisë së Ministrisë, të përfshira në mbikëqyrje.
3. Grupi i mbikëqyrjes që do të vijojë procesin në Institutin e Zhvillimit të Arsimit përbëhet nga inspektorët **Altin Shumeli**, përgjegjes grupi; **Valentina Kolleshi**, **Gentiana Biku** dhe **Stela Ndoka**, anëtar.
4. Grupi i mbikëqyrjes që do të vijojë procesin në Inspektoriatin Shtetëror të Arsimit përbëhet nga inspektorët **Aida Dobjani**, përgjegjës grupi; **Matilda Idrizi** dhe **Atalvin Niço**, anëtar.
5. Grupet e mbikëqyrjes të paraqiten në subjektet përkatëse në datën **24.03.2015**, për të filluar procesin me verifikimin e dokumentacionit.
6. Me këtë vendim të njihet Drejtori i Mbikëqyrjes, Grupet e mbikëqyrjes; Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit; Instituti i Zhvillimit të Arsimit dhe Inspektoriatit Shtetëror i Arsimit.
7. Ngarkohet Drejtorja e Mbikëqyrjes për të zbatuar këtë vendim.
8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA